



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 639, Datë 18.07.2019

**“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit
rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 609, datë 10.04.2019 vendosi “Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, për periudhën kohore nga 1 Janari 2018 deri në 31.03.2019, dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë Sindikatës Shqiptare së Taksive dhe Shoqatës së Taksive, si dhe është kërkuar informacion në mënyrë shkresore nga Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
3. Lidhur me kërkesën për informacion dërguar Bashkisë së Tiranës me shkresën Nr. 223/6

Prot., datë 07.05.2019, Bashkia e Tiranës i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës me shkresën Nr. 20907/1 Prot., datë 18.06.2019, protokolluar pranë AK me Nr. 223/7 Prot., datë 21.06.2019, jashtë afateve të përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative (15 ditë) dhe duke proceduar për marrjen e informacionit dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit.

4. Në vijim të procedurave, në datën 02.07.2019 AK i ka dërguar shkresën Nr. 418 Prot., “Kërkesë për Informacion” Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Informacioni i pritshëm nga shkresat do të ndihmonte Grupin e Punës në vlerësimin e strukturës së tregut dhe operimin e ndërmarrjeve në këtë treg.
5. Koha e mbetur në dispozicion, dhe mungesa e informacionit të kërkuar është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes ndërmarrjeve që operojnë në tregun e transportit rrugor të udhëtarëve taksì (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019.
6. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e transportit rrugor të udhëtarëve me taksì (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019 “Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksì (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, pika “III”, të ndryshohet si vijon:
“2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 14 Tetor 2019.”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS